L I G J
Nr. 8857, datë 7.2.2002

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7986, DATË 13.9.1995 "PËR INSPEKTORATIN SHTETËROR TË PUNËS", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8394, DATË 2.9.1998

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr.7986, datë 13.9.1995 "Për Inspektoratin Shtetëror të Punës", ndryshuar me ligjin nr.8394, datë 2.9.1998, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 27 ndryshon si më poshtë:

"Neni 27
Procedura dhe sanksione

1. Për shkeljet e dispozitave të legjislacionit të punës, inspektori i punës vendos gjobë ndaj kundërvajtësve deri në vlerën e pesëdhjetëfishit të pagës minimale.

2. Kundërshtimi dhe pengimi i inspektorëve në ushtrimin e detyrës përbën kundërvajtje dhe dënohet me gjobë nga 5 000 deri në 50 000 lekë.

3. Kur shkelja përbën vepër penale, zbatohen dispozitat përkatëse të Kodit Penal.

4. Kundër vendimit të inspektorit të punës mund të bëhet ankim, pranë Inspektorit të Përgjithshëm, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit.

Inspektori i Përgjithshëm shprehet dhe nxjerr vendim për ankimin brenda 30 ditëve nga data e regjistrimit të ankesës.

Kundër vendimit të Inspektorit të Përgjithshëm mund të bëhet ankim në gjykatën e shkallës së parë ku ka ndodhur kundërvajtja, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.

5. Vendimet e formës së prerë, të marra nga Inspektorati i Punës, janë tituj ekzekutivë dhe kur nuk zbatohen vullnetarisht nga kundërvajtësit, ekzekutohen nga zyrat e përmbarimit.".

Neni 2

Pas nenit 27 shtohet neni 27/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 27/1

1. Kur gjobat e vëna nga Inspektorati i Punës nuk ekzekutohen vullnetarisht, zyra e përmbarimit vë në sekuestrim një pjesë të pasurisë së kundërvajtësit, sa vlera e gjobës për 6 muaj.

2. Kur pas këtij afati nuk ekzekutohet vendimi, bëhet konfiskimi i pasurisë në vlerën e gjobës.".

Neni 3

Nenet 25, 26 dhe 26/1 të ligjit nr.7986, datë 13.9.1995 "Për Inspektoratin Shtetëror të Punës", ndryshuar me ligjin nr.8394, datë 2.9.1998, shfuqizohen.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3256, datë 11.2.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani